


Raport i shkurtër i zbatimit të Planit Strategjik për zhvillimin ekonomik 2005-2015

1. Gjendja e zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV

Strategjia ZhEV e Shkodrës përfshin 98 projekte. Që nga fundi i vitit 2008, pra tre vjet pas adoptimit të strategjisë ZhEV, ka 26 projekte të raportuara si të vëna në jetë (pra 27% e të gjithë projekteve të strategjisë ZhEV), 31 projekte të raportuara si projekte në vijim (32%) dhe 41 projekte të raportuara si të panisura për zbatim (41%). Veç projekteve të strategjisë ZhEV raportohen edhe 153 projekte të vëna në jetë që nuk janë përfshirë në strategjinë ZhEV.

Grafiku nr. 1 paraqet informacion për numrin e projekteve të vëna në jetë dhe grafiku nr. 2 paraqet informacion për statusin e zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV që nga fundi i vitit 2008.

Grafiku nr. 1. Numri i projekteve të vëna në jetë në 2005-2008 brenda kuadrit të strategjisë ZhEV.



Grafiku nr. 2. Gjendja e zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV që nga fundi i vitit 2008.



Në analizë të numrit të projekteve të vëna në jetë të strategjisë ZhEV mund të arrihet në përfundimin që zbatimi i projekteve është në vijë me tërë kuadrin kohor të strategjisë ZhEV, që është një plan strategjik dhjetë vjeçar. Por, duke marrë parasysh numrin e projekteve në vijim të strategjisë ZhEV dhe numrin domethënës të projekteve shtesë të vëna në jetë, duhet thënë që vënia në jetë e strategjisë ZhEV ka ecur ndjeshëm përpara.

1.1 Gjendja e zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV sipas synimeve

Komenti i përgjithshëm nga analiza e zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV të bërë për tërë strategjinë është që bashkia e Shkodrës ka ecur para me jetësimin e strategjisë së vet. Pyetja tjetër është se çfarë përpërimit u arrit me zbatimin e projekteve për çdo synim strategjik.

Strategjia ZhEV e Shkodrës ka pesë synime si vijon:

Synimi nr. 1: *Shkodra me një ekonomi vendore tërheqëse dhe sipërmarrje dinamike, ku nxiten e mbështeten bizneset prodhuese, tregtare, turistike dhe të shërbimeve që operojnë suksesshëm në tregun rajonal;*

Synimi nr. 2: *Ruajtja dhe zhvillimi i traditave dhe vlerave kulturore, historike dhe artistike të Shkodrës dhe çuarja e tyre përpara në funksion të zhvillimit të turizmit;*

Synimi nr. 3: *Qyteti të jetë qendër arsimore e nivelit të lartë për Shqipërinë e Veriut, me Universitetin si faktor kyç krijimin e një fuqie punëtore të arsimuar përmes rritjes dhe përmirësimit të nivelit arsimit akademik dhe profesional;*

Synimi nr. 4: *Një qytet me infrastrukturë e shërbime publike me standarde cilësore e bashkëkohore që nxitin dhe mbështetin zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë vendore në harmoni me mjedisin;*

Synimi nr. 5: *Arritja për qytetarët e Shkodrës e një jete më të shëndetshme duke promovuar sportet, duke përmirësuar mjediset sportive dhe aksesin e qytetarëve në shërbimet shëndetsore dhe sociale.*

Analiza e zbatimit të projekteve sipas qëllimeve të Strategjisë ZhEV tregon që zbatim më të avancuar ka në rastin e Synimit nr. 4 dhe, në vend të dytë, në rastin e Synimit nr. 3. Përpërimit më i ulët në jetësim paraqitet në kutitë e ngjyrosura të vendosura ngjitur me Synimet në listën e synimeve të Strategjisë ZhEV më sipër. Kutia e gjelbër tregon jetësim të mirë, e verdha tregon nivel mesatar zbatimi, ndërsa e kuqja ecuri të ulët në zbatim.


Tabela nr. 1 paraqet informacion në shifra për projektet e zbatuara dhe të pazbatuara sipas synimeve strategjike.

Tabela nr. 1. Gjendja e zbatimit të projektit sipas synimeve strategjike që nga fundi i vitit 2008.

	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5
Projekte të zbatuara të strategjisë ZhEV	3	3	3	13	4
Projekte në vijim të Strategjisë ZhEV	14	5	3	5	4
Projekte të panisura të Strategjisë ZhEV	13	8	6	7	7
Projekte të zbatuara të papërfshira në strategjinë ZhEV	0	4	38	111	4


Tabela nr. 1 shfaq informacion jo vetëm për projektet e Strategjisë ZhEV por edhe për projekte shtesë të jetësuar por të papërfshira në strategjinë ZhEV. Analiza vetëm e projekteve të Strategjisë ZhEV dhe gjendja e zbatimit të tyre paraqitet në Grafikon nr. 4.

Grafiku nr. 3. Gjendja e zbatimit të projekteve të Strategjisë ZhEV që nga fundi i vitit 2008.



Sipas Grafikut nr. 3 numri i projekteve të vëna në jetë të Strategjisë ZhEV është më i larti në rastin e Synimit 4 (13 projekte të zbatuara), më pas vjen Synimi 5 (4 projekte të zbatuara). Synimet 1, 2 dhe 3 kanë të njëjtin numër projektesh të zbatuara të Strategjisë ZhEV (3 projekte të zbatuara). Nga këndvështrimi i projekteve të panisura për zbatim, numri më i madh është në rastin e Synimit nr. 1 (13 projekte të panisura), mandej Synimi nr. 2 (8 projekte të panisura). Një pamje tjetër e gjendjes së zbatimit paraqitet në Grafikon nr. 4 që paraqet edhe informacion për projekte shtesë të vëna në jetë.

Grafiku nr. 4. Gjendja e zbatimit të të gjithë projekteve që nga fundi i vitit 2008.





Në kuptim të të gjitha projekteve të zbatuara (projekte të strategjisë ZhEV dhe ato shtesë) numri më i madh i projekteve të zbatuara është në rastin e Synimit 4 (124 projekte të zbatuara) dhe më pas vjen Synimi 3 (41 projekte të vëna në jetë).


1.2 Gjendja e zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV sipas programeve


Sipas strukturës së Strategjisë ZhEV programet i përkasin një niveli tjetër që gjendet poshtë nivelit të objektivave dhe mbi nivelin e projekteve. Kjo nënkupton që çdo program përbëhet nga projekte që janë elemente operacionale të Strategjisë ZhEV. Gjendja e zbatimit të programeve vlerësohet duke u mbështetur në gjendjen e zbatimit të projekteve për një program specifik. Duke pasur parasysh që 27% e projekteve të Strategjisë ZhEV raportohen si të zbatuara, gjendja e zbatimit të programeve që është në këtë nivel apo më sipër se ky nivel çmohet si “i mirë”. Kur gjendja e zbatimit të programit është më e ulët se 27% por ka më shumë projekte të raportuara si të zbatuara apo në proces zbatimi sesa projektet e panisura për zbatim, gjendja e zbatimit çmohet si “mesatare”. Në raste të tjera, gjendja e zbatimit të programit çmohet si “e ulët”. Informacioni për gjendjen e zbatimit të programit specifik paraqitet me fjalë dhe kuti të ngjyrosur ngjitur me titullin e programit. Gjendja e mirë e zbatimit shënohet me të gjelbër, gjendja mesatare e zbatimit shënohet me të verdhë dhe gjendja e ulët e zbatimit shënohet me të kuqe.

Vlerësimi i gjendjes së zbatimit të programeve të Strategjisë ZhEV tregon që vetëm 4 programe nga gjithsej 26 programe të Strategjisë ZhEV vlerësohen në nivel të ulët zbatimi dhe që ky zbatim duhet përmirësuar. Këto programe me nivel të ulët zbatimi janë si vijon:


 *Programi 1.2.1: Krijimi i veprimtarive të reja (origjinale) dhe materialeve promocionale për të lehtësuar zhvillimin e SME-ve të reja.*


 *Programi 1.3.1: Krijimi i strukturave për të nxitur e mbështetur veprimtari ndërkufitare.*


 *Programi 5.2.1: Nxitja dhe promovimi i ngjarjeve sportive në bashki.*


 *Programi 5.4.1: Përmirësimi i shërbimeve të kujdesit shëndetsor parësor në bashki.*


Vlerësimi tregon edhe që ka 6 programe që çmohen se janë në nivel mesatar zbatimi. Programet janë si vijon:


 *Programi 1.1.1: Sigurimi i shërbimeve publike cilësore dhe infrastrukturës në zonat industriale, në partneritet me komunitetin e biznesit të zonës.*

 *Programi 1.5.1: Mbështetje dhe zhvillim i infrastrukturës turistike.*

 *Programi 2.1.1: Mirëadministrim dhe ekspozim i trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës.*

 *Programi 3.1.3: Krijimi i partneriteteve dhe lidhjeve të qëndrueshme në kontekstin e zhvillimeve rajonale.*

 *Programi 4.5.1: Përmirësimi i gjelbërimit të rrugëve të qytetit.*

 *Programi 4.6.1: Përmirësimi i adminsitrimin të mbetjeve urbane bashkiake.*

16 Programet e tjera janë vlerësuar se janë në një nivel të mirë zbatimi. Rekomandohet që vitin e ardhshëm të zbatimit të strategjisë ZHEV, më shumë përpjekje duhet të bëhen në zbatimin e programeve në nivel të ulët dhe të mesëm duke ruajtur ecurinë e zbatimit të programeve të tjera.

Vlerësimi i gjendjes së zbatimit të programeve të strategjisë ZhEV pohon konkluzionet e vlerësimit të të gjithë strategjisë ZhEV. Në përgjithësi gjendja e zbatimit është vlerësuar në një nivel të përparuar.


 *Programi 1.1.1: Sigurimi i shërbimeve publike cilësore dhe infrastrukturës në zonat industriale, në partneritet me komunitetin e biznesit të zonës.*

Tabela Nr 2. Gjendja e zbatimit të Programit 1.1.1

Numri i Qëllimit	Numri i objektivit	Numri i Programit	Numri i Projektit	Titulli i projektit	Gjendja zbatimit të projektit
1	1	1	1	Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike në zonën industriale	2
1	1	1	2	Përmirësimi i ndriçimit të rrugëve në zonën industriale	2
1	1	1	3	Rehabilitimi i sistemit të kullimit të ujrave sipërfaqësore dhe atyre të zeza në zonën industriale	2
1	1	1	4	Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në zonën industriale	2
1	1	1	5	Instalimi i linjave telefonike dhe rinovimi i rrjetit ekzistues në zonën industriale	3
1	1	1	6	Përmirësimi dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra në zonën industriale	2

Zbatimi i programit vlerësohet në nivel “mesatar”. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën më lart nuk ka projekte të zbatuara, por raportohet që pesë projekte janë në proces zbatimi dhe vetëm një projekt (projekti nr. 1.1.1.5) raportohet si i panisur.

Programi 1.1.2: Promovimi i zonës industriale.

Tabela nr 3. Gjendja e zbatimit të programit 1.1.2

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja zbatimit të projektit
1	1	2	1	Hartimi i hartës së bizneseve që veprojnë në zonën industriale	2
1	1	2	2	Publikimi i materialeve promovuese për bizneset që veprojnë në zonën industriale	1

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar si “e mirë”. Sipas tabelës së dhënë më sipër është raportuar se në rastin e programit 1.1.2 një nga projektet është në procesin e zbatimit (projekti 1.1.2.1) dhe një tjetër është raportuar si i zbatuar (1.1.2.2).

Programi 1.2.1: Krijimi i materialeve promovuese dhe veprimtarive origjinale për të lehtësuar zhvillimin e NVM-ve të reja

Tabela nr. 4. Gjendja e zbatimit të Programit 1.2.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
1	2	1	1	Ngritja e zyrës me ‘Një ndalesë’ në Bashkinë e Shkodrës	1
1	2	1	2	Hartimi i profileve të bizneseve më të suksesshme të qytetit	3
1	2	1	3	Ngritja e një qendre për shërbimet ndaj biznesit	3
1	2	1	4	Anketimi dhe analiza e nevojave të NVM-ve që veprojnë në qytet	3
1	2	1	5	Kryerja e studimit mbi sigurimin e fuqisë punëtore dhe të kurseve të trajnimit për biznesin	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar si e “ulët”. Në rastin e programit 1.2.1 është raportuar që vetëm një projekt është zbatuar (projekti 1.2.1.1) dhe katër projekte nuk kanë filluar.

Programi 1.3.1: Ngritja e një strukture për nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërkufitare.

Tabela nr. 5. Gjendja e zbatimit të programit 1.3.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
1	3	1	1	Ngritja e një bordi për lehtësimin e ngritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar	3
1	3	1	2	Përgatitja e një pakete informuese për investitorët e huaj në lidhje me potencialet tregtuese dhe investuese në Shkodër	3
1	3	1	3	Ngritja e qendrës rajonale të trajnimit të biznesit	3
1	3	1	4	Ndërtimi i qendrës së panairëve të biznesit	3
1	3	1	5	Ngritja e një sistemi për menaxhimin e integruar të ekosistemit të liqenit të Shkodrës	2
1	3	1	6	Vënia në punë e shërbimit të transportit liqenor Shkodër - Virpazar, Mal i Zi	2

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar si e “ulët”. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën më sipër, është raportuar që në rastin e programit 1.3.1 vetëm dy projekte janë në procesin e zbatimit dhe katër të tjerat nuk kanë filluar.

Programi 1.4.1: Forcimi i sistemit të tregjeve publike ekzistuese të shitjes me shumicë dhe pakicë.

Tabela nr. 6. Gjendja e zbatimit të programit 1.4.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
1	4	1	1	Ndërtimi i tregut të shitjes me shumicë të fruta perimeve	1
1	4	1	2	Ndërtimi në qytet i tregjeve të reja për shitjen me pakicë të frutave, perimeve, peshkut dhe mishit	2

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar si “e mirë”. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën më sipër është raportuar që një projekt është zbatuar (projekti 1.4.1.1) dhe një projekt është në procesin e zbatimit (Projekti 1.4.1.2).

Programi 1.5.1: Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së turizmit.

Tabela nr. 7. Gjendja e zbatimit të programit 1.5.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
1	5	1	1	Zhvillimi i strategjisë së turizmit për qytetin e Shkodrës	3
1	5	1	2	Hapja pranë bashkisë së Shkodrës e Zyrës për Mbështetjen e Turizmit	2
1	5	1	3	Krijimi i një rrjeti hotelesh dhe restorantesh në qytet që të përmirësohen standartet e tyre dhe të bëjnë të larmishëm shërbimet e tyre	3
1	5	1	4	Hapja e një qendre tregtare të artizanatit	2
1	5	1	5	Organizimi periodik i trainimeve për ngritje kapacitetesh të agjencive turistike dhe bizneseve	3
1	5	1	6	Nxitja e turizmit familjar dhe agro-turizmit në Shirokë dhe Zogaj	2

1	5	1	7	Hartimi i strategjisë së marketingut të turizmit në qytetin e Shkodrës	2
1	5	1	8	Prodhimi i broshurës informative për ambientet shlodhëse e argëtuese, dhe shërbimet duke përfshirë hotelet, shërbimet e transportit, restorantet, etj.	2
1	5	1	9	Botimi i revistës periodike “Turizmi në Shkodër”	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar “mesatare”. Sipas informacionit të dhënë në tabelat e mësipërme nuk ka projekte të raportuara si të zbatuara por të pestë projektet janë në procesin e zbatimit gjë që është më shumë se katër projekte të panisura.

Programi 2.1.1: Mirëadministrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës.

Tabela nr. 8. Gjendja e zbatimit të programit 1.5.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
2	1	1	1	Ruajtja, restaurimi dhe zhvillimi i muzeut të qytetit dhe koleksionit të tij, si dhe i elementëve të tjerë historike e kulturore të qytetit.	2
2	1	1	2	Ngritja e sistemit për identifikimin, vlerësimin dhe blerjen e objekteve muzeale	2
2	1	1	3	Rehabilitimi dhe ekspozimi periodik i arkivit të sektorit historik të muzeut	3
2	1	1	4	Hapja e ekspozitës periodike numizmatike “Qarkullimi monetar në rajonin e Shkodrës”	3
2	1	1	5	Zgjerimi i eksponateve të Muzeut Arkeologjik	3
2	1	1	6	Përmirësimi i mjediseve të punës në Teatrin “Migjeni”	2
2	1	1	7	Rehabilitimi i qendrës kulturore të qytetit	2
2	1	1	8	Promovimi i koleksionit fotografik të Muzeut “Marubi”	3
2	1	1	9	Restaurimi i shtëpive tradicionale në qytet	2

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar “mesatare”. Sipas informacionit të prezantuar në tabelën e mësipërme pesë projekte janë raportuar në procesin e zbatimit dhe katër projekte të raportuara si të panisura.

Programi 2.1.2: Ringjallja dhe promovimi i ngjarjeve tradicionale historike dhe kulturore.

Tabela nr. 9. Gjendja e zbatimit të programit 2.1.2

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
2	1	2	1	Ngritja e komisionit për artin dhe kulturën	3
2	1	2	2	Krijimi i filarmonisë së qytetit	1
2	1	2	3	Zhvillimi i festës “Dita e Verës” në Shkodër	1
2	1	2	4	Festa e karnavaleve në Shkodër	1
2	1	2	5	Organizimi vjetor i festivalit	3
2	1	2	6	Hartimi dhe botimi i materialeve promocionale lidhur me trashëgiminë kulturore të qytetit	3
2	1	2	7	Përgatitja dhe botimi i kalendarit të aktiviteteve kulturore vjetore që do të mbahen në Shkodër	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar si e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme tre projekte janë raportuar të zbatuara dhe katër projekte të panisura.

Programi 3.1.1: Përmirësimi i infrastrukturës për akomodimin, mësimdhënien dhe shërbimet e tjera për studentët në universitet.

Tabela nr. 10. Gjendja e zbatimit të programit 3.1.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
3	1	1	1	Rehabilitimi i mjediseve ekzistuese dhe ndërtimi i mjediseve të reja për mësimdhënien në universitetin “Luigj Gurakuqi”	2
3	1	1	2	Ndërtimi i kampusit studentor në Universitetin “Luigj Gurakuqi”	3
3	1	1	3	Ndërtimi i bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”	1

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar si “e mirë”. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme është raportuar një projekt i zbatuar, një në proces zbatimi dhe një i panisur.

Programi 3.1.2: Rritja e cilësisë dhe zgjerimi i objektivit të kurrikulës dhe mësimdhënies në universitet.

Tabela nr. 11. Gjendja e zbatimit të programit 3.1.2

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
3	1	2	1	Krijimi i Akademisë së Arteve pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”	3
3	1	2	2	Ngritja e kurrikulës për degën e turizimit në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin Juridik dhe trainimi i administratës publike në Universitetin “Luigj Gurakuqi”	1
3	1	2	3	Zbatimi i projektit të edukimit në distancë në Universitetin “Luigj Gurakuqi”	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të prezantuar në tabelat e mësipërme është raportuar një projekt i zbatuar dhe dy projekte të panisura.

Programi 3.1.3: Krijimi i partneriteteve dhe lidhjeve të qëndrueshme në kontekstin e zhvillimeve rajonale.

Tabela nr. 12. Gjendja e zbatimit të programit 3.1.3

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
3	1	3	1	Hartimi dhe zbatimi i një programi shkëmbimesh për njohuritë shkencore dhe teknike mes Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe universiteteve të rajonit dhe më gjerë	2
3	1	3	2	Krijimi i një sistemi fondesh pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” që të mbështesë dhe të rritë kapacitetet kërkimore dhe të sigurojë transferimin e njohurive në fushën e zhvillimit ekonomik rajonal.	3
3	1	3	3	Rekrutimi dhe zhvillimi i personelit të kualifikuar akademik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në nivele që ofrojnë mësimdhënie cilësore dhe në përputhje me standartet e Deklaratës së Bolonjës.	2

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar mesatare. Sipas informacionit të paraqitur në tabelat e mësipërme nuk ka projekte të zbatuara, dy janë në proces zbatimi dhe një nuk ka nisur ende.

Programi 3.2.1: Rikonstruksioni i mjediseve arsimore parauniversitare të qytetit.

Tabela nr 13. Gjendja e zbatimit të programit 3.2.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
3	2	1	1	Rehabilitimi i shkollës së mesme “Preng Jakova”	3
3	2	1	2	Rehabilitimi i shkollës 9-vjeçare “Skënderbeg”	1
3	2	1	3	Rehabilitimi i kopshtit “Guerrile”	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme është raportuar një projekt i zbatuar dhe dy projekte të panisura.

Programi 4.1.1: Përmirësimi dhe rritja e instrumentave planifikuese për zhvillimin e menaxhimin urban të qytetit.

Tabela nr 14. Gjendja e zbatimit të programit 4.1.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
4	1	1	1	Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të bashkisë	2
4	1	1	2	Zhvillimi i planit të pjesshëm urban për zonën Shirokë – Zogaj	1
4	1	1	3	Zhvillimi i planeve të pjesshme urbane për zonat Mark Lulaj, Hardhijat e Egra dhe Zooteknikë	3
4	1	1	4	Hartimi i planit të veprimit për detajimin e planit rregullues të qytetit dhe të planeve të pjesshme	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme ka një projekt të zbatuar, një në proces zbatimi dhe dy projekte të panisura.

X Programi 4.2.1: Rehabilitimi i sistemit rrugor të qytetit.

Tabela nr 15. Gjendja e zbatimit të programit 4.2.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
4	2	1	1	Rikonstruksioni i 15 rrugëve të qytetit (Shtojca 4)	1
4	2	1	2	Rikonstruksioni i 12 trotuarëve të rrugëve urbane (Shtojca 4)	1
4	2	1	3	Rehabilitimi i ndriçimit publik të 8 rrugëve urbane (Shtojca 4)	1

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme ka tre projekte të zbatuara.

X *Programi 4.2.2: Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të bardha të qytetit.*

Tabela nr. 16. Gjendja e zbatimit të programit 4.2.2

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
4	2	2	1	Rehabilitimi i 5 daljeve të ujrave të bardha të qytetit (Shtojca 4)	1

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme ka një projekt të zbatuar.

Programi 4.3.1: Rehabilitimi i sistemit të ujrave të zeza të qytetit.

Tabela nr. 17. Gjendja e zbatimit të programit 4.3.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
4	3	1	1	Rehabilitimi i stacionit të pompimit të ujrave të zeza	1

4	3	1	2	Ndërtimi dhe rehabilitimi i tubave të daljes së shkarkimeve të ujrave të zeza	1
4	3	1	3	Përmirësimi i teknologjisë së mirëmbajtjes së sistemit të ujrave të zeza	3
4	3	1	4	Ndërtimi i linjave të reja të kanalizimeve të ujrave të zeza	3

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme është raportuar se dy projekte janë zbatuar dhe dy nuk kanë nisur ende.

X *Programi 4.4.1: Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.*

Tabela nr. 18. Gjendja e zbatimit të programit 4.4.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
4	4	1	1	Përfundimi i ndërtimit të kompleksit të rezervuarëve të ujit të pijshëm në kodrat e Tepës	1
4	4	1	2	Instalimi i saraçineskave të reja në sistemin shpërndarës të ujit të pijshëm	1
4	4	1	3	Rehabilitimi i rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm	1
4	4	1	4	Instalimi i pajisjeve ndihmëse për menaxhimin e shpërndarjes së ujit të pijshëm	1

Gjendja e zbatimit të programit është vlerësuar e mirë. Sipas informacionit të paraqitur në tabelën e mësipërme është raportuar që të gjitha projektet e programit janë zbatuar.

Programi 4.5.1: Përmirësimi i gjelbërimit të rrugëve të qytetit.

Tabela nr. 19. Gjendja e zbatimit të programit 4.5.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
4	5	1	1	Rehabilitimi i gjelbërimit në rrugët kryesore të qytetit	2

Programi 4.5.2: Rehabilitimi i parqeve kryesore publike.

Tabela nr. 20. Gjendja e zbatimit të programit 4.5.2.

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja zbatimit të projektit
4	5	2	1	Rehabilitimi i lulishtes pranë pazarit	3
4	5	2	2	Rehabilitimi i lulishtes “Luigj Gurakuqi”	1

Programi 4.5.3: Ndërtimi i zonave të reja të gjelbra pranë zonave të banimit.

Tabela nr. 21. Gjendja e zbatimit të programit 4.5.3

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja zbatimit të projektit
4	5	3	1	Ndërtimi i lulishtes brenda bllokut të banimit “Xhabije”	1
4	5	3	2	Ndërtimi i lulishtes së rrugës “Isuf Sokoli” në bllokun e banimit “Baçja e Çakajve”	3
4	5	3	3	Ndërtim i lulishtes në lagjen Zdrale	3

Programi 4.6.1: Përmirësimi i administrimit të mbeturinave të ngurta bashkiake.

Tabela nr. 22. Gjendja e zbatimit të programit 4.6.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja zbatimit të projektit
4	6	1	1	Ndërtimi i vend-depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane	2
4	6	1	2	Përmirësimi i teknologjisë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të ngurta urbane	2
4	6	1	3	Fushatë sensibilizuese “mbaj Shkodrën pastër”	2

Programi 5.1.1: Ndërtimi i mjediseve të reja publike argëtuese dhe për aktivitete sportive, si dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese.

Tabela nr. 23. Gjendja e zbatimit të programit 5.1.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
5	1	1	1	Ngritja në qytet e një qendre për të rinjtë	3
5	1	1	2	Rehabilitimi i mjediseve sportive në shkollat e qytetit	2
5	1	1	3	Ndërtimi i këndeve publike dhe private të lojrave	2
5	1	1	4	Ndërtimi i sallës së mbyllur të atletikës	1
5	1	1	5	Ndërtimi i palestrës së mundjes	3

Programi 5.2.1: Nxitja dhe promovimi i veprimtarive sportive në qytet.

Tabela nr. 24. Gjendja e zbatimit të programit 5.2.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
5	2	1	1	Zhvillimi i kampionateve amatore sportive mes shkollave 9-vjeçare, atyre të mesme dhe për të rritur në stinët e pranverës dhe të vjeshtës	3

Programi 5.3.1: Modernizimi i shërbimit të gjendjes civile.

Tabela nr. 25. Gjendja e zbatimit të programit 5.3.1

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
5	3	1	1	Informatizimi i Zyrës së Gjendjes Civile	1

5	3	1	2	Krijimi i sistemit, dhe software-it të adresave të Bashkisë Shkodër	2
---	---	---	---	---	---

Programi 5.3.2: Përmirësimi dhe shtimi i numrit të shërbimeve sociale që ofrohen për komunitetin.

Tabela nr. 26. Gjendja e zbatimit të programit 5.3.2

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
5	3	2	1	Kryerja e studimit për vlerësimin e situatës sociale për banorët e Shkodrës	2
5	3	2	2	Shtim i kapaciteteve të administratës bashkiake dhe OJF-ve vendore për ofrimin e shërbimeve sociale	1
5	3	2	3	Ngritja e 3 qendrave sociale për grupet e mënjanuara të komunitetit dhe ofrimi i shërbimeve sociale në bashkëpunim mes Bashkisë dhe OJF-ve vendore	1

Programi 5.4.1: Përmirësimi i shërbimeve të kujdesit shëndetsor parësor në bashki.

Tabela nr. 27. Gjendja e zbatimit të programit 5.4.1.

Numri i qëllimit	Numri i objektivit	Numri i programit	Numri i projektit	Titulli i projektit	Gjendja e zbatimit të projektit
5	4	1	1	Rindërtimi i qendrës së shëndetit për komunitetin në Tre Heronjt	3
5	4	1	2	Rindërtimi i qendrës së shëndetit komunitar në Partizani	3
5	4	1	3	Rindërtimi i qendrave të shëndetit në Zogaj e Shirokë	3
5	4	1	4	Ndërtimi i një qendre të re shëndeti në Vojo Kushi	3

2.Gjendja e financimit të zbatimit të strategjisë ZhEV

Kostoja totale e planifikuar për zbatimin e projekteve të strategjisë ZhEV është 7,605,777 mijë lekë. Që nga fundi i vitit 2008 raportohet që janë shpenzuar 2,034,610 mijë lek për zbatimin e projekteve të Strategjisë ZhEV (27% e tërë koston së planifikuar). Veç kësaj, u shpenzuan 1,146,287 mijë lek për zbatimin e projekteve shtesë të papërfshira në Strategjinë ZhEV. Kjo jep vlerën e përgjithshme prej 3,180,897 mijë lek për zbatimin e të gjitha projekteve në periudhën 2005 – 2008. Grafiku nr. 5 paraqet informacion për kostot e planifikuara dhe ato reale të projekteve dhe grafiku nr. 6 paraqet informacion për gjendjen e financimit të Strategjisë ZhEV.

Grafiku nr. 5. Kostot e planifikuara dhe reale të projekteve brenda kuadrit të Strategjisë ZhEV.



Grafiku nr. 6. Gjendja e financimit të Strategjisë ZhEV.



Gjendja e financimit të strategjisë ZhEV (kostot reale të zbatimit të projekteve të strategjisë ZhEV si % e kostove totale të planifikuara që në fund të vitit 2008 është 27%) është e ngjashme me gjendjen e zbatimit të projekteve të Strategjisë ZhEV. Por, duke marrë parasysh fondet e shpenzuara për zbatimin e projekteve shtesë që raportohen si 1,146,287 mijë lek, gjendja e financimit të strategjisë ZhEV është më e avancuar. Prapëseprapë, sipas strategjisë ZhEV ka ende 5,571,167 mijë lek që nevojiten të shpenzohen për të zbatuar plotësisht Strategjinë ZhEV.

2.1 Gjendja e financimit të zbatimit të strategjisë ZhEV sipas qëllimeve

Tabela nr. 28 paraqet informacion për kostot e planifikuara dhe reale të zbatimit të projekteve sipas synimeve të strategjisë ZhEV.


Tabela nr. 28. Kostot e planifikuara dhe reale të zbatimit të projekteve sipas synimeve të strategjisë ZhEV (mijë lek).

	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5
Kostot e planifikuara të projekteve të strat ZhEV (mijë lek)	1,335,249	76,280	120,248	5,847,513	226,487
Kostot reale të projekteve të strat ZhEV (mijë lek)	324,606	3,180,897	21,891	1,571,701	51,990
Kostot reale të projekteve jo të strat ZhEV (mijë lek)	0	0	283,862	843,187	19,238
Kostot totale reale të gjithë projekteve (mijë lek)	324,606	3,180,897	305,753	2,414,888	71,228

Sipas tabelës nr. X zbatimi është më i përparuar në rastin e Qëllimit 2 (shpenzuar 3,180,897 mijë lek ndërkohë që kostot e planifikuara ishin vetëm 76,280 mijë lek). Ky ndryshim domethënës mes kostove të planifikuara dhe reale duhet të jetë objekt i një analize më të thellë pasi në kuptim të zbatimit të projekteve Qëllimi 2 nuk është më i përparuari.

Gjendja e financimit të strategjisë ZhEV sipas synimeve të treguara në Grafikon nr.7.

Grafiku 7. Gjendja e zbatimit të strategjisë ZhEV sipas qëllimeve.




2.2 Burime financimi për zbatimin e Strategjisë ZhEV

Zbatimi i strategjisë ZhEV bëhet përmes buxheteve vjetore bashkiake. Burim kryesor i financimit të zbatimit të strategjisë ZhEV janë transfertat shtetërore (të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara) si dhe të ardhurat e vetë bashkisë. Tabela nr. 29 paraqet fondet e shpenzuara për zbatimin e projekteve të strategjisë ZhEV në periudhën 2004 – 2008 dhe, i njëjti informacion në formë grafiku, paraqitet në Grafikon nr. 8.

Tabela 29. Burimet për financimin e zbatimit të strategjisë ZhEV

Viti	Bashkia	Shteti	Dhurues	Gjithsej
2004	5,733	121,345	10,000	137,078
2005	25,682	316,284	233,975	575,941
2006	49,767	602,467	290,604	942,838
2007	147,519	603,041	0	750,560
2008	262,891	483,085	29,575	775,551
Gjithsej	491,592	2,126,222	564,154	3,181,968

Grafiku nr. 8. Burime për financimin e zbatimit të strategjisë ZhEV



Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 29 dhe në Grafikun nr. 8 në vitin 2006, niveli i financimit të strategjisë ZhEV ishte më i larti, kryesisht falë financimit nga shteti dhe donatorët. Në vitin 2007 dhe 2008 niveli i financimit të strategjisë ZhEV është më i ulët sesa në 2006 por, gjithsesi mjaft më i lartë se në vitin 2004. Një tjetër koment me rëndësi është që në vitet 2005 dhe 2006 burimet kryesore të financimit të strategjisë ZhEV janë shteti dhe donatorët por në vitet 2007 dhe 2008 financimi nga të ardhurat e vetë bashkisë është grupi i dytë më i madh i financimit të zbatimit të strategjisë ZhEV. Kjo prirje e mirë në financimin e strategjisë ZhEV konfirmohet edhe nga zyrtarët vendorë të intervistuar që thanë që në fillim të zbatimit të strategjisë ZhEV ata mbështeteshin kryesisht tek fondet e qeverisë qendrore dhe donatorët; tashmë ata varen sërish nga fondet e shtetit por, njëherazi, kanë më shumë të ardhura të veta që mund t'i përdorin për të financuar strategjinë.